

**APLIKIMI PËR TARIFA OPERATORIT TË  
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR NIVEL  
TENSIONI 2020**

**OSSH sh.a.**

**Operatori i Sistemit të Shpërndarjes**

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023  
Tiranë

**PËRMBAJTJA**

<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>3</b>
1.1	Vështrim i Përgjithshëm.....	3
1.2	Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura .....	5
1.3	Përlllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni.....	7
1.4	Indeksi i çmimit të konsumitorit .....	8
1.5	Kursi i Këmbimit Valutor .....	9
1.6	Aktivite në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë.....	9
<b>II.</b>	<b>PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI</b> .....	<b>43</b>
2.1	Të Dhënat dhe Metodologjia Bazë.....	43
2.2	Bilanci Energjistik 2017 - 2024.....	44
2.3	Ulja e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes.....	45
2.4	Plani i furnizimit në nivel tensioni i klientëve të OSSH .....	45
<b>III.</b>	<b>SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE</b> .....	<b>46</b>
3.1	Shpenzime për blerjen e energjisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.....	46
3.2	Shpenzime për transmetimin dhe çmimi mesatar i blerjes.....	47
<b>IV.</b>	<b>PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)</b> .....	<b>47</b>
4.1	Përmbledhje për shpenzimet operative .....	47
4.2	Shpenzimet për Mirëmbajtje.....	51
<b>V.</b>	<b>ASETET BAZË TË RREGULLUARA</b> .....	<b>59</b>
5.1	Përlllogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara.....	59
5.2	Investimet (CAPEX).....	60
5.3	Kapitali i punës .....	61
<b>VI.</b>	<b>PËRLLLOGARITJA E NORMËS SË INTERESIT TË BORXHIT</b> .....	<b>61</b>
<b>VII.</b>	<b>PESHA MESATARE E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT (WACC)</b> .....	<b>62</b>
<b>VIII.</b>	<b>TË ARDHURAT E KËRKUARA PËR SHPËRNDARËSIN E ENERGJISË</b> .....	<b>63</b>
8.1	Të ardhura nga Lidhjet e Reja dhe Energjia Reaktive .....	65
8.2	Korrigjimi i Të Ardhurave .....	65
<b>IX.</b>	<b>PËRLLLOGARITJA E TARIFËS PËR NIVEL TENSIONI</b> .....	<b>65</b>
9.1	Përlllogaritja e shpenzimeve operative .....	66
9.2	Kosto e humbjeve.....	66
9.3	Vlera e Aseteve Bazë të Rregulluara dhe Përlllogaritja e WACC .....	66
9.4	E ardhura e kërkuar për nivel tensioni dhe tarifa .....	67
<b>X.</b>	<b>PROPOZIM PËR TARIFË NË NIVEL TENSIONI PËR OSSH</b> .....	<b>68</b>
<b>XI.</b>	<b>TARIFA E MIRËMBAJTJES NË ZERO KWH DHE TË TJERA</b> .....	<b>68</b>
<b>XII.</b>	<b>PLANI INVESTIMEVE TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2020</b> .....	<b>69</b>

## **I. PËRMBLEDHJE**

### **1.1 Vështrim i Përgjithshëm**

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e tarifës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes bazohet në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015, “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” si dhe Metodologjisë së Përcaktimit të Tarifave të Operatorit të Sistemit Shpërndarjes të Energjisë Elektrike aprovuar nga ERE më 10.11.2017.

Krijimi ligjërishit i shoqërisë OSSH në 28.03.2018 mundësoi fillimin e strukturimit të saj dhe në mënyrë që të jetë plotësisht funksionale në zbatim të liçencës së shpërndarjes së energjisë. Për arsye të fazës përgatitore të organizimit të OSSH por edhe për shkak të procesit të zgjatur të ndarjes së OSHEE në shoqëri bija, OSSH nuk arriti ta bënte atë akoma funksionale ushtrimin e liçencës së marrë gjatë periudhës 2018 – 2019 e cila ju rikthye përkohësisht OSHEE deri në ndarjen përfundimtare të shoqërisë e cila do të fillojë të funksionojë plotësisht në fillim të vitit 2020.

OSHEE prej krijimit dhe deri në fund të vitit 2019 vazhdon të ushtrojë aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Ndryshimet rrënjësore në administrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike krahas atij të shitjes, prej fundvitit 2014, sollën përmirësime dhe suksese të jashtëzakonshme në performancën financiare të OSHEE, e cila brenda një kohe të shkurtër 2015 – 2018 arriti të akumulojë një fitim neto prej rreth 38 miliard Lekë, ndërkohë që prej krijimit të shoqërisë në vitin 2007 dhe deri në fund të vitit 2014 kishte akumuluar vetëm humbje të vazhdueshme për çdo vit për një total prej rreth 104 miliard Lekë.

Me kalimin 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar, menaxhimi dhe strategjia e shoqërisë OSHEE janë pjesë e strategjisë kombëtare që Qeveria po ndjek në të gjithë sektorët, përfshirë këtu sektorin energjistik pjesë e të cilit është kjo shoqëri.

Si pjesë e strategjisë së zhvillimit të sektorit Qeveria Shqiptare hartoi platformën e Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike në fillim të vitit 2015, e cila u pasua nga Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik Elektroenergjitik miratuar në Prill 2019, ku fokusi kryesor ishte përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike, rritja e normës së arkëtimit me qëllim krijimin e një shoqërie financiarisht të qëndrueshme për të garantuar furnizimin e energjisë elektrike konsumatorëve. Në vazhdim të reformave të ndërmara u aprovua në Parlament ligji Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 i cili ndryshoi tërësisht modelin aktual të tregut të energjisë. Në këtë kuadër krahas punës për përmirësimin e treguesve të përcaktuar në platformë sa më sipër OSHEE është duke u përgatitur për ndryshimet që lidhen me tregun e liberalizuar të shërbimeve të shitjes dhe shpërndarjes.

Në zbatim të platformës së hartuar nga Qeveria Shqiptare dhe me mbështetjen tërësore të saj OSHEE hartoi një program të detajuar ndërhyrjeje në të gjithë vendin i cili bëri të mundur frenimin e humbjeve dhe përmirësimin e treguesve ekonomik – financiarë të shoqërisë në një periudhë të shkurtër. Lufta kundër paligjshmërisë, përmirësimi i shërbimeve dhe arkëtimi i detyrimeve të prapambetura janë në qendër të punës së përditëshme për menaxhimin e OSHEE krahas përmirësimit dhe modernizimit të rrjetit.

Viti 2017 ishte një vit i vështirë për gjithë sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri për shkak të thatësisë që uli në mënyrë drastike prodhimin vendas të KESH dhe HEC-ve private duke detyruar OSHEE të blejë energji në tregun e lirë me çmim mesatar 8.9 Lekë/Kwh nga 3 Lekë/Kwh që ishte planifikuar. OSHEE shpenzoi 14.2 miliard Lekë më shumë se vlera e planifikuar për blerjen e energjisë elektrike.

Rezultatet e vitit 2018 megjithëse positive nuk arritën treguesit e performancës së planifikuar në fillim të periudhës si rezultat i rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë, e cila u ndikua nga ndryshimi i strukturës së blerjes dhe rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike në tregun e lirë. Sasia e prodhuar nga burimet hidrike vendase në vitin 2018 ishte më e madhe e prodhuar ndonjëherë, por kjo rritje u evidentua kryesisht në 6 – mujorin e I-rë i cili ishte shumë i lagësht, ndërsa tremujori i II-të u karakterizua nga thatësi e madhe e cila rriti tej planifikimit importin e energjisë në këtë pjesë të vitit.

Gjatë 2018 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan 14 % ose 3.5 miliard Lekë më të larta se ato të planifikuara në fillim të vitit dhe çmimi mesatar i blerjes së energjisë ishte 5.32 Lekë/Kwh nga 4.07 Lekë/Kwh i planifikuar. Faktorët që ndikuan në rritjen e kostos së blerjes së energjisë ishin:

- *Ndryshimi i strukturës së furnizimit në OSHEE si rezultat i detyrimit për të blerë me përparësi energji të prodhuar nga HEC-et private me çmim rreth 8.56 Lekë/Kwh.*
- *Energjia e furnizuar nga KESH më e ulët se planifikimi*
- *Rritja e çmimit të energjisë në tregun e lirë*

Viti 2019 është sërish një vit i thatë dhe për shkak të mosplotësimit të sasisë së planifikuar të furnizimit nga KESH i cili do të furnizojë OSHEE në vetëm rreth 70% të sasisë së planifikuar dhe rreth 65% të sasisë së furnizuar në vitin 2018, kosto e blerjes së energjisë pritet të rritet ndjeshëm. OSHEE do të shpenzojë rreth 13.1 miliard Lekë më shumë se sa planifikimi për blerje të energjisë në vitin 2019 dhe rreth 9.3 miliard Lekë më shumë se sa në vitin 2018. Kosto e blerjes së energjisë për vitin 2019 pritet të jetë 5.91 Lekë/Kwh nga 4.13 Lekë/Kwh që ishte planifikuar. Parashikimi i performancës financiare të OSHEE për vitin 2019 tregon për një **humbje financiare prej rreth 7.7 miliard Lekë.**

Ndikimi negativ i Rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë në rezultatin e vitit 2018 dhe 2019 u zvogëluar nëpërmjet masave të marra në përmirësim të treguesve ekonomik financiarë, të cilat synojnë:



- ✓ Zvogëlimin e humbjeve jo-teknike nëpërmjet forcimit të kontroleve në rrjet, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe vendosjes para ligjit të abuzuesve si dhe nëpërmjet investimeve që përmirësojnë teknologjinë dhe organizimin e punës.
- ✓ Zvogëlimin e shpenzimeve operative nëpërmjet masave të marra për kontrollin rigoroz të tyre.
- ✓ Rritjen e arkëtimit nëpërmjet politikave të ristrukturimit të borxhit dhe përmirësimit të marrëdhënieve me klientët duke përmirësuar shërbimin dhe rritur besimin reciprok.
- ✓ Rritjen e efikasitetit të punës së punonjësve të shoqërisë nëpërmjet masave organizative, rritjes së kualifikimit dhe motivimit të punonjësve.
- ✓ Përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet investimeve në teknologji të përparura që përmirësojnë treguesit teknikë të furnizimit.
- ✓ Zvogëlimin e kohës së ndërprerjeve teknologjike dhe të kohëzgjatjes së riparimit të defekteve në rrjet.

### 1.1.1 Statusi Ligjor i Shoqërisë

Në dallim me periudhat e mëparshme kur ndryshimet e shpeshta në statusin ligjor të shoqërisë që nga krijimi i OSSH në vitin 2007 u lidhën me privatizimin dhe kalimit të 74% aksioneve në pronësi të CEZ a.s. duke e kthyer atë në CEZ Shpërndarje dhe më pas me heqjen e liçencës, kalimit të shoqërisë në administrim të përkohshëm nga ERE si dhe kalimit të 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar në fund të vitit 2014, ndryshimet e pritëshme në fund të këtij viti lidhen me nevojën e hapjes së tregut të energjisë elektrike në zbatim të programit të qeverisë dhe direktivave të Komunitetit Europian.

Në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 shoqëria është duke përfunduar procesin e ndarjes financiare të aktiviteteve të saj në plotësim të kërkesave të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” për ndarjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Këto ndryshime do të sjellin sigurisht edhe ndryshime në statusin ligjor të shoqërisë sipas kërkesës së ligjit duke filluar nga 01.01.2020.

Ndarja e shoqërisë, përkundrajt vazhdimin të punës për përmirësimin e treguesve ekonomik – financiarë dhe menaxherialë, bazuar në aktivitetet e liçensuara është një proces që po zhvillohet nën këshillimin e konsulencës dhe eksperiencës më të mirë vendase dhe të huaj dhe nën vëzhgimin dhe ndjekjen hap pas hapi në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Qeverisë Shqiptare.

### 1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Operatorit të Shpërndarjes për vitin 2020 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Përlllogaritja e tarifës në zbatim të ligjeve në fuqi ka marrë parasysh gjendjen e vështirë financiare që po kalon shoqëria. Në përlllogaritjen e të Ardhurës së Kërkuar janë llogaritur edhe humbjet e si pasojë e mosrealizimit të furnizimit nga KESH gjatë vitit 2017 dhe 2019, për shkak të thatësisë së zgjatur e cila u shoqërua me mosrealizim të prodhimit.
- ii. Çmimet për Shërbimet për Operatorin e Shërbimit të Shpërndarjes me të cilat HEC-et private, prodhuesit nga Burime të Rinovueshme dhe OST i shesin energji dhe shërbim transmetimi OSSH janë supozuar, 8.46 Lekë/Kwh për energjinë e blerë nga HEC private, 12.46 Lekë/Kwh për energjinë e blerë nga prodhuesit nga Burime të Rinovueshme dhe në 0.75 Lekë/Kwh për shërbimin e transmetimit nga OST.
- iii. Energjia për humbjet në rrjet mbulohet nga prodhimi i HEC-eve private dhe nga prodhuesit nga Burime të Rinovueshme, ndërsa në rastet kur sasia e prodhuar nga ato është më e vogël se sasia e humbjeve në rrjet diferenca do të blihet në Tregun e Lirë.
- iv. Përlllogaritja e kërkesës për energji për mbulimin e humbjeve është bazuar në parashikimin për vitin në vazhdim por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.
- v. Zhvillimet pozitive të ekonomisë Shqiptare janë marrë parasysh në moslllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjionime të mundshme për efekt të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të shpenzimeve.

Sasia e energjisë së injektuar në sistem për vitin 2020 parashikohet të jetë 6,495 Gwh. Sasia e energjisë së shitur parashikohet të jetë 5,196 Gwh dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë 1,299 Gwh duke parashikuar që niveli i humbjeve të jetë 20%.

Zbatimi i planit të investimeve sipas planit afatgjatë të aprovuar ka sjellë rezultate në uljen e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve. Megjithatë ndikimi është pjesor dhe efektet më të mëdha në uljen e humbjeve në rrjet sipas planit të hartuar do të kenë ndikim të plotë në performancën financiare të shoqërisë, pasi investimet të jenë shtrirë në përmirësim të pjesës më të madhe të rrjetit. Investimet janë mbështetur dhe do të vazhdojnë të mbështeten kryesisht në burime të brendshme të shoqërisë (fitimi vjetor i realizuar) si edhe në financimin sipas kredisë së Bankës Botërore. Investimet e parashikuara të kapitalizohen për vitin 2020 janë 8.935 miliard Lekë nga të cilat rreth 1.6 miliard Lekë nga kredia e Bankës Botërore.

Shpenzimet Operative në kushte të një shoqërie të re dhe pa shpenzime historike janë llogaritur bazuar në studimin bashkëngjitur, në të cilin për shpenzimet operative të OSHEE e të njëjtës

natyrë janë ndarë duke përdorur koeficientë të ndryshimit bazuar në faktorë të përbashkët. Menaxhmenti i shoqërisë i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve, megjithatë është ndeshur me nevojën e rritjes të disa prej tyre nga viti në vit për të rritur performancën duke ushtruar një kontroll më të madh në përmirësimin e sistemit të faturimit. Kostot e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penalitete të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat sipas metodologjisë nuk janë marrë parasysh në llogaritje.

***Rritja e kostove të blerjes së energjisë për shkak të mungesës së prodhimit vendas si dhe për shkak të ndryshimit të strukturës së blerjes ka krijuar një të ardhur të munguar që llogaritet në 12.44 miliard Lekë për periudhën 2015 – 2019 e cila duhet të kompensohet duke korrigjuar të ardhurat e kërkuara në çmimin e shitjes së energjisë. Në përllogaritjet e vitit 2020 është propozuar që kompensimi të kryhet nga tarifa e shpërndarjes, duke pasur parasysh faktin se shërbimi i shpërndarjes ka krijuar pjesën më të madhe të humbjeve të trashëguara pjesë e kapitalit negativ të OSHEE në periudhën 2012 – 2014 për rreth 52 miliard Lekë. Për të kompensuar kapitalin negativ të trashëguar në aplikimin për tarifë është propozuar që 3 miliard Lekë për 4 vitet e ardhëshme ti shtohen tarifës së shpërndarjes për çdo vit.***

Nga përllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura për Operatorin e Shpërndarjes në vitin 2020 kap shifrën e rreth 31 miliard Lekë.

### **1.3 Përllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni**

Përllogaritja e tarifës së shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni buron si nevojë e hapjes së tregut në plotësim të kërkesave të ligjit për energjinë si dhe vendimeve të ERE. Duhet theksuar se metodologjia për llogaritjen e tarifës së shpërndarjes përcakton detyrimin e përllogaritjes së tarifës në nivel tensioni por nuk detajon qartësisht mënyrën e llogaritjes. OSHEE është akoma në proces të ndarjes së aktivitetin e shpërndarjes dhe shitjes dhe nuk ka akoma sistem të ndarë të evidentimit të treguesve financiarë. Treguesit që mund të përdoren janë tregues të konsoliduar, prandaj edhe llogaritja e tarifës në nivel tensioni bazohet kryesisht në koeficientë të gjetur të alokimit të shpenzimeve dhe jo në matjen e tyre të drejtpërdrejtë si më poshtë:

- i. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë megjithë investimet e viteve të fundit është akoma shumë i vjetëruar dhe si i tillë është gati e pamundur të përcaktohen qartë kostot oportune të investimeve të nevojshme për sjelljen e tij në parametra të transmetimit cilësor, prandaj përllogaritja e kostos së transmetimit për nivel tensioni bazohet në koeficientë të shpërndarjes (allokimit) vlera e të cilëve, mund të jetë e kontestueshme metodologjikisht.

- ii. Vetë rrjeti i shpërndarjes së energjisë si pasojë e mungesës së investimeve të plota dhe ndërhyrjeve të shpeshta në kushtet e emergjencave është i paqartë qoftë për ndarjen sipas peshës specifike të përdorimit të tij nga paisjet sipas nivelit të tensionit ashtu edhe në përcaktimin e humbjeve për çdo nivel tensioni.
- iii. Sistemi i informacionit (marrjes së të dhënave) për kostot e drejtpërdrejta të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë do të mund të plotësohet vetëm pas ndarjes së shoqërisë në Operatorin e Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe ndarja e kostove operative është kryer mbi bazën e një studimi me koeficientë të përafrimit.
- iv. Përlllogaritja e përgatitur më poshtë është mbështetur në Kërkesën për të Ardhura dhe çmimin e blerjes së energjisë për mbulimin e kostos së humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike nga HEC private dhe prodhuesit e Energjisë së Rinovueshme.
- v. Të dhënat që zotërojmë janë të pamjaftueshme për të përlllogaritur vlerën e saktë të Aseteve Bazë të Rregulluara (RAB) për nivel tensioni, prandaj për këtë si edhe për Peshën Mesatare të Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) janë përdorur koeficientë shpërndarjeje (alokimi) të cilët mundësojnë përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Shpërndarjes në nivel tensioni.
- vi. Alokimi sipas koeficientëve të llogaritur mbi bazë të energjisë së shitur për nivel tensioni dhe niveli i humbjeve të njohura për çdo nivel tensioni, kanë qenë baza për shpërndarjen e shpenzimeve operative, shpenzimeve për humbjet e energjisë elektrike në rrjet dhe vlerës së Aseteve Bazë të Rregulluara për llogaritjen e të ardhurave për mbulimin e kostos së kapitalit.

Nga përlllogaritjet në zbatim të metodologjisë dhe koeficientëve të shpërndarjes (alokimit) rezulton se tarifa për tensionin 35 kV duhet të jetë 3.68 Lekë/kwh, për tensionin 20 – 6 kV 4.32 Lekë /kwh dhe për tensionin e ulët 6.35 Lekë/kwh. Megjithatë në rast se struktura e shitjes në bazë tensioni ndryshon, ndryshon edhe baza e shpërndarjes (alokimit) dhe përlllogaritjet duhet të ndryshojnë dhe duhet të kompensohen në periudhat e ardhshme.

#### **1.4 Indeksi i çmimit të konsumatorit**

Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2019 tenton të jetë rreth 1.3%.





Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshmërinë e treguesve ekonomikë të Shqipërisë në përlogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

### 1.5 Kursi i Këmbimit Valutor

Sipas të dhënave të mëposhtme të marra nga faqja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë 2019 si në grafikun më poshtë dhe tendencës për vitin 2020, kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1 EURO= 123 Lekë.



### 1.6 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë

#### 1.6.1 Treguesit Kryesorë të krahasuar të OSHEE gjatë vitit 2019 (i pritshëm)

Treguesit kryesorë të performancës së OSHEE (të pritshëm) gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 paraqiten në tabelën si më poshtë:



## OSSH sh.a.

000/Lekë	Përshkrimi	2017	2018	Parashikim 2019	Diferenca 2019-2018	%
<b>Të Ardhurat</b>	Të ardhura nga Shitja e energjisë	52,893,726	53,972,323	55,903,828	↑ 1,931,505	104%
	Të ardhura nga kamatëvonesat	1,104,307	1,089,313	1,088,023	↓ (1,289)	100%
	Të ardhura nga Shpërndarja (Lidhje të reja)	649,137	674,851	722,045	↑ 47,194	107%
	Të tjera	5,675,266	868,519	183,842	↓ (684,677)	21%
	<b>Gjithsej</b>	<b>60,322,436</b>	<b>56,605,006</b>	<b>57,897,738</b>	<b>↑ 1,292,733</b>	<b>102%</b>
<b>Shpenzimet</b>	Shpenzime Energji dhe Transmetim	39,606,411	34,193,492	43,940,149	↓ 9,746,658	129%
	Shpenzime Operative	12,222,982	11,339,486	15,369,297	↓ 4,029,811	136%
	Provizione	2,651,553	4,745,583	2,799,461	↑ (1,946,121)	59%
	<b>EBITDA</b>	<b>5,841,491</b>	<b>6,326,445</b>	<b>(4,211,170)</b>	<b>↓ (10,537,615)</b>	<b>-67%</b>
	Amortizimi	2,528,909	3,086,800	3,208,160	↓ 121,360	104%
	Shpenzime Financiare	16,515	(45,179)	247,561	↓ 292,740	-548%
	Tatim Fitimi	1,575,808	1,337,449	-	↑ (1,337,449)	0%
	<b>Gjithsej</b>	<b>58,602,176</b>	<b>54,657,630</b>	<b>65,564,629</b>	<b>↓ 10,906,999</b>	<b>120%</b>
<b>REZULTATI I AKTIVITETIT</b>		<b>1,720,261</b>	<b>1,947,375</b>	<b>(7,666,891)</b>	<b>↓ (9,614,266)</b>	<b>-394%</b>
	Të ardhura të Jashtëzakonëshme	109,899	-	-		
<b>REZULTATI I PERIUDHES</b>		<b>1,830,160</b>	<b>1,947,375</b>	<b>(7,666,891)</b>	<b>↓ (9,614,266)</b>	

### ENERGJI (MHW)

	Energji e Blerë	6,498,321	6,436,911	6,547,677	110,766
	Energji e Shitur	4,781,998	4,883,784	5,059,704	175,921
	Energji e Shitur FMF		14,624		
<b>Humbje %</b>		<b>26.41%</b>	<b>23.90%</b>	<b>22.73%</b>	<b>↑ -1.18%</b>

Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të OSHEE gjatë vitit 2019 janë si mëposhtë:

- *Rezultati financiar i vitit 2019 pritet të jetë një humbje prej 7.7 miliard Lekë duke shënuar rezultatin e parë negativ pas 4 viteve me performancë të suksesshme.* Rritja e kostos së blerjes së energjisë elektrike për shkak të thatësirës është treguesi kryesor që ka ndikuar në humbjen e pritshme pavarësisht masave të marra për uljen e kostove të operacionale të shoqërisë.
- *Rritje e shpenzimeve për energjinë e blerë:* Gjatë 2019 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan 29 % ose 9.7 miliard Lekë më shumë se 2018. Si rezultat i thatësirës së zgjatur prodhimi dhe furnizimi me energji nga KESH me çmim të rregulluar 1.5 Lekë/Kwh u ul ndjeshëm duke detyruar shoqërinë të blejë energji në tregun e importit me çmim mesatar prej rreth 9.2 Lekë/Kwh. Kosto e energjisë së blerë për tariforët për shkak të mosfurnizimit nga KESH pritet të jetë 5 Lekë nga 4.13 Lekë të planifikuar me një efekt prej rreth 5.6 miliard Lekë më shumë.
- *Rritje e të Ardhurave nga Energjia:* Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë pritet të rezultojnë 4% më të larta ose 1.9 miliard Lekë më shumë, kushtet e thatësirës dhe verës së nxehtë rritën ndjeshëm përdorimin e energjisë elektrike.
- *Të ardhurat nga kamatëvonesat mbeten në të njëjtin nivel me ato të vitit 2018 dhe 2017:* Përgjithësisht masat e marra në aksionin kundër lidhjeve të paligjshme dhe në përmirësimin e arkëtimeve kanë përmirësuar ndjeshëm marrëdhënien e OSHEE me klientët duke rritur ndjeshëm arkëtimet. Rritja e pagesave në afat si dhe politikat e

ristrukturimit të detyrimeve kanë sjellë uljen e të ardhurave nga kamatëvonesat në krahasim me periudhën 2014 – 2016.

- *Shpenzimet operative për 2019 pritet të jenë 36% më të larta se ato të vitit 2018.* Me gjithë kujdesin e treguar nga drejtimi menaxherial i shoqërisë për shkak të rritjes së penaliteteve (nga KESH për mospagesa të faturave të energjisë përpara vitit 2015 prej 2.3 miliard Lekë, si dhe për çështje përmbartimore) shpenzimet operative do të rriten, ndonëse të gjithë treguesit e tjerë të shpenzimeve operative tregojnë ulje të ndjeshme në krahasim me treguesit e planifikuar.
- Arkëtimet pritet të jenë sa 97% e vlerës së faturuar e cila është 2% më e lartë se parashikimi në buxhet si dhe në Planin e Rimëkëmbjes prej 95%.
- Shpenzimet financiare që lidhen kryesisht me ndryshime në normat e këmbimit për kreditë e trashëguara në monedha të ndryshme.
- OSHEE ka paguar 100% faturat korente ndaj KESH, OST dhe Posta Shqiptare si dhe 1.2 miliard Lekë më shumë ndaj KESH për kredinë ndaj EBRD.

## 1.6.2 Aktiviteti i Shpërndarjes

### 1.6.2.1 Hyrje

#### Përshkrimi i Rrjetit

Në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike të OSHEE, energjia elektrike dërgohet në përdoruesit e saj ( Industri,banesa etj).

Rrjeti shpërndarës TL/TM/TU që menaxhohet nga OSHEE sh.a përbëhet nga elementët si vijon:

Nr.	Kategoria e rrjetit shpërndarës	Sasia sipas njesive		Mosha mesatare e Paisjeve/Rrjetit
		Numri	Km	Vjet
1	N/Stacioni 110/35120/10/6 K v	178		38
2	N/Stacioni 110/20 Kv	14		12
3	Rrjeti shperndares 35 kV		1262	40
4	Rrjeti shperndares 10 kV		7.600,67	40
5	Rrjeti shperndares 16 kV		0	0
6	Rrjeti shperndares 6kV		5,322.51	40
7	Rrjeti shperndares 20 kV		2401.93	12
7	Rrjeti shperndares 0.4 kV		24628	38
8	Transformoret 110/35/20/10/6 kV	311		38
9	Transformoret 35/10/6 kV			
10	Transformoret 20/0.4kV	6157		12
11	Transformoret 10/0.4kV	1005		35
12	Transformoret 6/0.4 kV	10256		35

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.I, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë



<b>LINJA TM/TU</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Tensioni</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
	Linja ajrore	6 kV	km	4,777.14
		10 kV	km	7,413.49
		20 kV	km	189.73
		35 kV	km	1,132.20
	<b>Totali Linja ajrore</b>			<b>km</b>
<b>LINJA TM</b>	Linja kabllore	6 kV	km	545.37
		10 kV	km	187.18
		20 kV	km	2,212.20
		16 kV	km	15.54
		35 kV	km	10
	<b>Totali Linja kabllore</b>			<b>km</b>
<b>Totali Linja TM</b>			<b>km</b>	<b>16,472.85</b>
<b>LINJA TU</b>	Linja ajrore	0.4 kV	km	18,668
	Linja kabllore	0.4 kV	km	2,085
	Linja ABC	0.4 kV	km	2,876
	<b>Totali Linja TU</b>			<b>km</b>

Sektori energjitik vazhdon të përballet me sfida siç janë zhvillimet ekonomike në sektorë të ndryshëm, trendi i konsumit të energjisë për klient etj.

Sfidat në sektorin e energjisë në çdo vend të botës janë hallka të pandara të zhvillimit ekonomik.

Megjithëse kanë kaluar rreth 30 vjet nga ardhja e demokracisë Ekonomia Shqiptare vazhdon të përjetojë procesin e transformimit nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu.

OSHEE sha zhvillon aktivitetin e saj si furnizuese me shumicë të energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit në Republikën e Shqipërisë.

OSHEE është përgjegjëse për:

- përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,
- sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;
- mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është liçencuar.

***Situata aktuale***

Rrjeti Shpërndarës gjatë vitit 2019, me gjithë problematikat e mbartura ndër vite në OSHEE sh.a. vazhdon të përballet me problematikat e mëposhtme:

***Vjetërsia e rrjetave dhe pajisjeve:***

Shfrytëzimi i një pjese të konsiderueshme të tyre në regjim të mbingarkuar.

## OSSH sh.a.

Për shkak të infrastrukturës së vjetër dhe mbingarkesave të energjisë elektrike, me gjithë investimet dhe përmirësimet që OSHEE ka realizuar edhe gjatë periudhës 2018, hasi vështirësi në menaxhimin e rrjetit, i cili u reflektua:

- në cilësinë e furnizimit me energji elektrike që i ofroi konsumatorëve,
- në numrin e ndërprerjeve, në kohëzgjatjen e ndërprerjeve,
- në nivelin e humbjeve teknike dhe jo-teknike.

Përdoruesit e Rrjetit Shpërndarës të OSSH janë këto kategori:


- Konsumatorët Fundorë (FSHU),
- Furnizuesit e Liçensuar (për konsumatorët në Treg të Liberalizuar),
- Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike.

OSSH ka aktualisht kontratë me 205 Prodhues me Përparësi të Energjisë Elektrike. Nga të cilët 198 janë Hydro dhe 7 Fotovoltaik.


Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike injektojnë në Rrjetin e OST-së dhe OSHEE-së sipas raportit të paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Këta prodhues janë lidhur në rrjetin e OSSH-së sipas skemës të përgjithshme paraqitur si më poshtë:




Ndërsa sipas Niveleve të Tensionit dhe Burimit Gjenerues, Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike paraqesin këtë raport:



Grafiku i mëposhtëm paraqet Kapacitetet Shtesë të injektuara në total nga grupi i Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike (kryesisht si rezultat i rritjes në numër të tyre) në vite:



## KAPACITET E SHTUARA



***Pikat e dobëta që duhet të vlerësoheshin për arritjen e target-eve:***

### **Humbjet teknike**

- Rrjeti tejet i amortizuar, përfshirë moshën mesatare të nënstacioneve mbi 40 vjet;
- Mirëmbajtje jo e plotë e nënstacioneve, amortizim i transformatorëve etj,
- Investime të pamjaftueshme për përrnirësimin e infrastrukturës të rrjetit të shpërndarjes
- Mbingarkesa e elementëve të sistemit si transformatorë, fidera, përcjellës etj
- Kompesimi i pamjaftueshëm i energjisë reaktive
- Mos ri-konfigurimi i fiderave dhe linjave dhe transformatorëve të fuqisë, në mënyrë që të reduktohen gjatësitë e tyre
- Përdorimi pa eficensë i transformatorëve me fuqi të vogël.

### **Humbjet komerciale**

- Ndërhyrjet e paligjshme në rrjet nga të cilat përfitohen sasi të mëdha dhe të vogla energjie
- Eficensë e ulët e matjes
- Matësa të palexuar
- Leximi i matësave të cilët kanë gabim në matje të pa vënë re.
- Faturim jo eficient
- Nënfaturim
- Shpërndarje e keqe e faturave të energjisë
- Gabime të programeve të cilët I BS
- Cështje ligjore të zvarritura
- Mbledhje e pamjaftueshme e të ardhurave

Dhe arritjen e treguesve të performaces (SAIFI dhe SAIDI), tregues tepër të rëndësishëm për performancën e rrjetit shpërndarës , të cilët i vuri në vlerësim për cdo investim që u krye në rang rajoni apo OSHEE.

Qëllimi kryesor i investimeve është që të rrisë cilësinë e shërbimit të ofruar nga OSHEE për konsumatorët, për të përmirësuar humbjet teknike të rrjetit të shpërndarjes, si dhe për të ofruar shërbime në të ardhmen të shpërndarjes së energjisë për një afat shkurtër (3 vjet) dhe afatgjatë në formatin e masterplanit jo më pak se (15 vjet) të ndarë në plane ekonomike 5-vjecare në një mënyrë të qëndrueshme, të besueshme, cilësore, efikase dhe ekonomike.

Përveç kësaj, duke siguruar një rrjet optimal dhe të thjeshtë që mundëson operim të thjeshtë, lehtësi dhe fleksibilitet të mirëmbajtjes, synojnë gjithashtu rënien e shpenzimeve operative nëpërmjet standartizimit të materialeve, realizimin e procesit të kontroll- monitorimit me anë të sistemeve teknologjike (SCADA, MDM etj).

Vizioni i OSHEE për investimet që u kryen gjatë vitit 2019 ishte si vijon:

- Të realizonte ulje të humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe jo-teknike), e matur kjo me përqindjen e humbjeve për Mwh.
- Të realizonte rritje të normës së arkëtimeve, e matur kjo me përqindjen e arkëtimeve për të gjithë energjinë e faturuar.
- Të kishte përmirësim të treguesit të cilësisë së furnizimit përmes futjes së treguesve të performancës.

#### **1.6.2.2 Treguesit e Bilancit Energjistik në rrjetin e OSHEE për vitin 2019**

Treguesit mbi sasi të furnizuara me pakicë të energjisë elektrike

*Sasi të transmetuara / furnizuara*

Periudha që u mbyll më 9/2019 u karakterizua nga rritje të kërkesës për energji në masën 4.51% ose rreth 166 Gwh më shumë duke arritur në 4,925 Gwh 2019 kundrejt 4,759 Gwh në po të njëjtën periudhë të 2018. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e:

- Kërkesës për konsum të konsumatorit Fundor në masën 5.4% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë

#### ***Vëllimi i sasive të transmetuara***

Sasia e energjisë elektrike e transmetuar për OSHEE deri në fund 9M 2019 arriti në sasinë 5,394,229 MWh (për konsumatorin FSHU dhe FMF). Më poshtë do të gjeni të dhënat mujore:

Vëllimet e sasive të transmetuara FSHU dhe FMF 9M/2019 vs 9M/2018

Muajt	2018		2019		2019 vs 2018
	Energji në rrjetin e OSHEE Sh.a _FSHU	Energji në rrjetin e OSHEE Sh.a _FMF	Energji në rrjetin e OSHEE Sh.a _FSHU	Energji në rrjetin e OSHEE Sh.a _FMF	Energji tansmetuar FSHU/FMF
Janar	655,242	4,536	730,562	2,799	10.00%
Shkurt	586,309	4,513	582,519	2,398	-1.00%
Mars	590,543	6,446	553,859	2,439	-7.30%
Prill	463,159	4,086	494,497	3,002	6.10%
Maj	461,452	4,616	495,358	2,336	6.40%
Qershor	462,383	5,230	494,118	2,748	5.90%
Korrik	502,293	5,260	525,646	3,728	4.10%
Gusht	533,316	5,165	557,659	3,641	4.10%
Shtator	465,468	5,338	465,665	3,430	-0.40%
Tetor	471,407	3,812			
Nëntor	517,882	3,728			
Dhjetor	681,162	3,956			
<b>Progresive 9M</b>	<b>4,720,166</b>	<b>45,190</b>	<b>4,899,882</b>	<b>26,521</b>	<b>3.30%</b>


Vëllimet e sasive të transmetuara për konsumatorët e dalë në treg të parregulluar krahasimi 9M/2019 vs 9M/2018:

Muajt	2018		2019		2019 vs 2018
	Nr Konsumatorëve	Energji e trensmetuar për konsumatorët e dal në treg të lirë	Nr Konsumatorëve	Energji e trensmetuar për konsumatorët e dal në treg të lirë	Energji e trensmetuar për konsumatorët e dal në treg të lirë
Janar	-		3	2,451,958	100.00%
Shkurt	-		-	2,076,336	100.00%
Mars	3	605,668	-	3,032,990	80.00%
Prill	3	1,172,249	-	2,986,671	60.80%
Maj	-	1,400,312	1	3,366,979	58.40%
Qershor	-	1,271,559	3	3,863,225	67.10%
Korrik	-	1,340,059	4	4,467,482	70.00%
Gusht	-	652,116	1	4,487,497	85.50%
Shtator		<u>1,150,264</u>	<u>1</u>	<u>3,857,842</u>	<u>70.20%</u>
Tetor	6	2,340,004			



## OSSH sh.a.

Nëntor	-	2,250,866			
Dhjetor	4	2,441,352			
<b>Progresive 9M</b>	<b>6</b>	<b>7,592,227</b>	<b>13</b>	<b>30,590,980</b>	<b>75.20%</b>



Për numrin e konsumatorëve 35 kV që aktualisht janë në treg të liberalizuar, sasia e energjisë së transmetuar në MWh 2018, 9M/2019, parashikimi vjetor 2019 dhe 2020 (parashikim sipas kërkesës së furnizuesit të licencuar)-2024:

Vitet	NR Kontrate ne treg te liberalizuar	JO-BUXHETORE	PRIVAT	Kontrate FMF-35 kV furnzim nga FSHU sha
<b>2018</b>	16	10	69	79
<b>2019</b>	29	11	59	70
<b>2020</b>	<u>87</u>	<u>11</u>	<u>0</u>	<u>11</u>
<b>2021</b>	<u>87</u>	<u>11</u>	<u>0</u>	<u>11</u>
<b>2022</b>	<u>87</u>	<u>11</u>	<u>0</u>	<u>11</u>
<b>2023</b>	<u>87</u>	<u>11</u>	<u>0</u>	<u>11</u>
<b>2024</b>	<u>87</u>	<u>11</u>	<u>0</u>	<u>11</u>

MUAJT	2018		2019		2020 (parashikim)	
	Nr.konsumatorëve të dalë në treg të liberalizuar	Sasia e transmetuar ne kWh	Nr i konsumatorëve të dalë në treg te liberalizuar	Sasia e transmetuar në kWh	Nr i konsumatoreve te dal ne treg te liberalizuar	Sasia e transmetuar në kWh
Janar	0	-	19	2,452	87	6,648
Shkurt	0	-	19	2,076	87	6,408
Mars	3	606	19	3,033	87	6,600

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

## OSSH sh.a.

Prill	6	1,172	19	2,987	87	6,528
Maj	6	1,400	20	3,367	87	6,648
Qershor	6	1,272	23	3,863	87	6,528
Korrik	6	1,340	27	4,467	87	6,648
Gusht	6	652	28	4,487	87	6,648
Shtator	6	1,150	29	3,858	87	6,528
Tetor	12	2,340		-	87	6,648
Nentor	12	2,251		-	87	6,528
Dhjetor	16	2,441		-	87	6,648
<b>TOTAL 35 kV ne treg te lire</b>	<b>16</b>	<b>14,624</b>	<b>29</b>	<b>30,591</b>	<b>87</b>	<b>79,008</b>

Plani i veprimeve të ndërmarra nga OSSH gjatë 9 Mujorit të parë të 2019 arriti nivelin e humbjeve në masën 22.51%. Sipas bilancit energjistik të OSHEE për 9M/ 2019, ka një përmirësim të dukshëm të humbjeve të energjisë krahasuar me vitet e mëparshme:

<b>HUMBJET TOTALE Mujore/Vjetore</b>													
<b>Muajt/Vitet</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>Progressive</b>
2013	51.1%	48.7%	48.3%	39.7%	39.5%	40.3%	43.4%	38.6%	35.1%	46.0%	48.3%	53.0%	45.1%
2014	47.0%	42.1%	42.8%	35.7%	36.8%	34.1%	36.6%	36.4%	31.7%	34.5%	32.9%	37.5%	37.8%
2015	36.7%	31.8%	32.9%	30.5%	31.2%	28.6%	30.6%	29.3%	25.3%	29.9%	30.8%	34.5%	31.3%
2016	34.7%	29.0%	29.9%	26.1%	27.0%	24.3%	26.0%	25.2%	22.1%	27.1%	29.3%	31.0%	28.0%
2017	33.5%	27.6%	28.7%	25.8%	25.9%	28.1%	24.7%	23.5%	20.0%	23.8%	23.6%	27.9%	26.4%
2018	30.6%	24.9%	27.3%	23.4%	23.1%	20.8%	21.5%	20.8%	19.4%	21.6%	22.8%	26.8%	24.0%
2019	29.3%	23.2%	25.5%	21.4%	22.1%	19.9%	20.4%	19.8%	17.5%	0.0%	0.0%	0.0%	22.5%

**Tabela e Humbjeve krahasimore 9M 2013 - 2019**

<b>TREGUESIT E BILANCIT 2013-2019</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
<u>Humbjet 9M</u>	43.42%	38.69%	31.11%	27.56%	26.80%	23.90%	22.51%
2019 vs 2018		4.73%	7.58%	3.55%	0.76%	2.89%	1.39%
2019 vs 2017							4.29%
2019 vs 2016							5.05%
2019 vs 2015							8.60%
2019 vs 2014							16.18%
2019 vs 2013							20.91%

- Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë 9/2018, kemi një reduktim të humbjeve në masën 1.39%, (22.51% në fund të 9M 2019 ndaj 23.90% në fund të 9M 2018)
- Krahasuar me periudhën 9/2017, rezulton një rënie e konsiderueshme në masën 4.27% (22.51% në fund të 9M 2019 ndaj 26.80 % në fund të 9M 2017)
- Krahasuar me periudhën 09/2016, rezulton një rënie e konsiderueshme në masën 5.05%

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë




## OSSH sh.a.

- (22.51% në fund të 9M 2019 ndaj 27.56% në fund të 9M 2016)
- Deri në vlerën 20.91% krahasuar me 9M/2013 (22.51% në fund të 9M 2019 ndaj 43.42% në fund të 9M 2013)

Energjia e hyrë në rrjetin e Shpërndarjes gjatë 9M 2019, ka qenë rreth 3.7% më shumë se e njëjta periudhë kohore e një viti më parë. Edhe pse kërkesa për energji elektrike është rritur, niveli i humbjeve është reduktuar në masën 1.4%.

Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e Bilancit të Energjisë për OSHEE në periudhën 9 mujore Janar – Shtator 2013- 9M/2019:




### Bilanci Energjistik 9M 2013-2019

#### a) Treguesit e humbjeve totale, teknike dhe joteknike

OSHEE vazhdon me plane të ndryshme veprimesh për përmirësimin e treguesve të humbjeve me qëllim përmbushjen e objektivave të kompanisë. Këtu përmendim:

- Investimet në rrjetin TM/TU
- Sistemimi i kabinave dhe boxe-ve
- Projektet Smart Meter
- Verifikimi i sistemit të matjes
- Kontrolle të anomalive të evidentuara gjatë procesit të leximit.
- Rritjen e kontrolleve në terren për reduktimin e abuzimeve në rrjet.
- Rritjen e kontrolleve të brendshme me qëllim faturimin sa më korrekt të konsumatorit.
- Ndërgjegjësimin e konsumatorit për rëndësinë e mos shpërdorimit të Energjisë Elektrike etj.



Plani i veprimeve të ndërmarra nga OSHEE në mbështetje me grupet e interesit gjatë 9 Mujorit të 2019 arriti nivelin e humbjeve për rrjetin e shpërndarjes në 22.90% dhe parashikon që në fund të vitit 2019 niveli i humbjeve të energjisë të arrijë në 22.5%.

TREGUESIT E BILANCIT ENERGETIK	9M 2018	9M 2019
	(Progresive)	(Progresive)
<b>Energjia Totale ne rrjetin e Shpërndarjes</b>	<b>4,766,460</b>	<b>4,955,725</b>
Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes	<b>1,137,485</b>	<b>1,108,682</b>
<b>Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes (%)</b>	<b>23.86%</b>	<b>22.37%</b>
<b>Energji për klientët e OSHEE Sh.a të lidhur në rrjetin e shpërndarjes</b>	<b>4,758,868</b>	<b>4,925,134</b>
Humbjet për klientët e OSHEE Sh.a të lidhur në rrjetin e shpërndarjes	<b>1,137,485</b>	<b>1,108,682</b>
Humbje për klientët e OSHEE Sh.a të lidhur në rrjetin e shpërndarjes (%)	<b>23.90%</b>	<b>22.51%</b>
Humbjet teknike në njësitë e TL	93,865	89,248
Humbjet teknike në njësitë e TL (%)	1.97%	1.80%

Bilanci Energjistik i rrjetit të Shpërndarjes 9M/ 2019 krahasuar me vitin e mëparshëm

*b) Humbjet totale të energjisë për 9 mujorin Janar- Shtator 2019*

Humbjet Totale të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike) për periudhen 9 mujore Janar - Shtator 2019 për kompaninë OSHEE-sha për secilin Rajon të Shpërndarjes jepet në tabelën e mëposhtme:

Rajonet Shpërndarëse	Humbjet Totale (Janar-Shtator) 2019			
	Blerja e Energjise	Faturimi	Humbjet	%
	MWh	MWh	MWh	
Tirane	1,724,661	1,485,421	239,240	13.87%
Durres	651,266	511,703	139,563	21.43%
Fier	326,519	278,425	48,094	14.73%
Elbasan	294,505	240,609	53,896	18.30%
Korce	222,973	181,361	41,611	18.66%
Gjirokaster	207,771	168,654	39,117	18.83%

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë



## OSSH sh.a.

Shkoder	492,022	300,975	191,047	38.83%
Berat	270,218	217,025	53,193	19.69%
Kukes	126,274	57,779	68,495	54.24%
Burrel	265,719	182,022	83,697	31.50%
Vlore	251,020	189,527	61,493	24.50%
<b>Humbjet në TM&amp;TU</b>	<b>4,832,947</b>	<b>3,813,500</b>	<b>1,019,447</b>	<b>21.09%</b>
<b>Humbjet në TL</b>	<b>89,248</b>		<b>89,248</b>	<b>1.81%</b>
<b>Humbjet 9 M 2019</b>	<b>4,925,134</b>	<b>3,816,439</b>	<b>1,108,695</b>	<b>22.51%</b>
<b>Energji e trasmetuar klienteve 35 kV</b>	<b>30,591</b>	<b>30,591</b>		
<b>Humbjet Total OSHEE 9 M 2019</b>	<b>4,955,725</b>	<b>3,847,030</b>	<b>1,108,695</b>	<b>22.37%</b>

Në tabelën e mëposhtme jepet krahasimi i rezultateve kryesore vitin 2018 për 9M 2019:

<b>Humbjet</b>	<b>2018</b>	<b>9M 2019</b>	<b>Reduktimi humbjeve</b>
TM&TU	22.45%	21.09%	1.35%
TL	1.96%	1.81%	0.14%
Total OSHEE	23.96%	22.51%	1.44%

### 1.6.2.3 Analiza e treguesve të performancës së rrjetit për periudhën Janar – Tetor 2019

Kompania OSHEE si operator i vetëm i sistemit të shpërndarjes në themel të punës së saj ka për detyrë:

a- të sigurojë një regjistrim korrekt të ndërprerjeve të energjisë elektrike të shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, për të pasur tregues të performancës për sa i përket vazhdueshmërisë së furnizimit. Treguesit duhet të jenë të besueshëm, të krahasueshëm dhe lehtësisht të verifikueshëm në mënyrë që informacioni të jetë i saktë për klientët dhe të interesuarit e tjerë lidhur me vazhdueshmërinë e furnizimit;

b- të përmirësojë vazhdueshmërinë e shërbimit të furnizimit në nivel kombëtar dhe për të ulur diferencat ndërmjet zonave të ndryshme të furnizimit;

c- të kufizojë numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve vjetore që pësojnë klientët, duke i siguruar një rimbursim të përcaktuar në rastet e tejkalimit të standarteve specifike të përcaktuara në këtë Rregullore;

OSHEE kryen regjistrimin e ndërprerjeve, të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave që disponon, nëpërmjet sistemit të regjistrimit të vazhdueshmërisë së shërbimit, duke funksionuar për të gjitha linjat TL dhe TM të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe OSHEE mban regjistrin e ndërprerjeve për të gjitha llojet e ndërprerjeve të përmendura më sipër, i cili përmban:

a- Origjinën e ndërprerjes;

b- Shkakun e ndërprerjes;

c- Numrin e klientëve në TL të përfshirë në ndërprerje;

d- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje;

e- Numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

## OSSH sh.a.

f- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;

g- Numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;

h- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rildhjes, të ndarë sipas kategorive;

i-Datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndërprerjes, për të gjithë klientët të përfshirë në ndërprerje.

j-Çdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë, e cila regjistrohet dhe përdoret në llogaritjen e treguesve të performancës SAIDI dhe SAIFI.

- Koeficienti i ndërprerjes së energjisë elektrike për klient gjatë një viti, përcaktohet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$SAIFI = \frac{\sum_{i=1}^k N_i}{N_T}$$

SAIFI – (System Average Interruption Frequency Index) koeficienti i ndërprerjes për klient.

- Kohëzgjatja e përgjithshme e ndërprerjes për klient, që lidhet me ndërprerjet e planifikuara dhe ndërprerjet e gjata të paplanifikuara, përcaktohet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K D_i \cdot N_i}{N_T}$$

SAIDI - (System Average Interruption Duration Index) koeficienti i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes për klient.

- a) Realizimi i treguesve gjatë muajve të vitit 2019
- b)

Performanca TOTAL OSHEE Viti 2018 - 2019

Viti	SAIFI		SAIDI		CAIDI	
	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2019
Janar	2.87	2.73	6.23	5.02	4.34	1.84
Shkurt	3.42	3.68	7.39	8.56	4.31	4.25
Mars	4.25	2.28	8.78	4.52	4.46	4.27
Prill	2.54	2.39	4.38	5.31	3.73	4.71
Maj	3.16	2.28	5.63	4.74	4.03	2.08
Qershor	3.03	2.31	4.80	3.75	3.55	3.04
Korrik	2.65	2.64	4.52	4.38	3.35	1.66
Gusht	2.59	1.99	4.00	3.28	3.10	3.16
Shtator	2.37	2.38	4.91	4.60	4.36	3.73



c) Analiza e difekteve të shkaktuara në nyje të ndryshme të rrjetit:

Për të analizuar ecurinë e vazhdimet të amortizimit të paisjeve të rrjetit shpërndarës kemi marrë në analizë peshën specifike që zenë gjatë viteve secila prej tyre tek performanca e përgjithëshme e rrjetit shpërndarës.

Rrjeti TL (nënstacione 110/35/20/10/6kV dhe linja 35kV) kanë përmirësim të dukshëm në vlerë duke ulur peshën specifike që zënë tek totali i performancës së rrjetit shpërndarës gjatë periudhave **Gjithashtu** theksojmë se kemi përmirësim të peshës specifike të Linjave TL nga 9.6% në 2016 është bërë 6.8%

Si dhe janë rritur vlerat e peshës specifike për stakime të tjera (stakimet për masë sigurie dhe mbingarkesë në rrjetin TL) nga 0.8% në 2016 ka shkuar në vlerën 4.0% për periudhën Janar-Korrik 2019.

Masë sigurie për punime të OST si ajo e projektit të rimëkëmbjes së energjisë me vendosjen e sistemit matës në fiderat TM, punime rikonstruksioni apo remonte.

Faktorët që kanë ndikuar në përmirësimin e treguesve të furnizimit edhe pse vazhdon amortizimi i transformatorëve të fuqisë, impianteve 6-10kV, linjat 35kV janë:

- Realizimi i rikonstruksionit të 14 linjave 35kV
- Përdorimi me efikasitet i paisjeve të blera si çelsa, thika, TRF, Tr Tensioni, TR Rryme në zvogëlimin e nyjeve kritike .
- Implementimi i sistemit Scada në nënstationet e Tiranës.
- Kryerja e remonteve sipas kërkesave të protokolleve të remonteve dhe përdorimi i paisjeve të kontrollit dhe testimit të paisjeve primare dhe sekondare .
- Dispeçeria Qëndrore TL ka organizuar dhe planifikuar me efektivitet kthimin e skemave të furnizimit në kohë sa më të shkurtër dhe në anën 110kV ka kordinuar veprimet me QDS të OST-së.
- Zbatimi i rregulloreve të shfrytëzimit dhe ato të vendit të punës nga ana e operatorëve të nënstationeve.

Emri i pajisjeve	SAIFI				SAIDI			
	Janar-Shtator 2016	Janar-Shtator 2017	Janar-Shtator 2018	Janar-Shtator 2019	Janar-Shtator 2016	Janar-Shtator 2017	Janar-Shtator 2018	Janar-Shtator 2019
Linjë	2.19	1.47	1.62	1.24	6.41	3.24	3.68	2.71
Nënstacion	1.65	1.35	1.06	1.36	3.25	2.60	2.63	3.53
Transformator	0.99	0.99	1.04	0.81	2.06	2.14	1.76	1.06
Çela/10/20/35	1.19	1.02	0.92	0.67	2.35	2.05	1.67	1.21
Të ndryshme	0.33	0.09	0.51	0.96	0.51	0.12	0.42	1.55
<b>HV</b>	<b>6.35</b>	<b>4.92</b>	<b>5.14</b>	<b>5.04</b>	<b>14.59</b>	<b>10.15</b>	<b>10.17</b>	<b>10.06</b>
Fidera	18.83	15.86	17.57	14.35	46.72	33.24	35.42	29.42
Çela Kabine	5.81	3.97	4.26	3.31	8.64	5.44	5.36	4.67
<b>MV</b>	<b>24.64</b>	<b>19.84</b>	<b>21.84</b>	<b>17.66</b>	<b>55.36</b>	<b>38.68</b>	<b>40.78</b>	<b>34.09</b>
<b>Total OSHEE</b>	<b>30.99</b>	<b>24.75</b>	<b>26.97</b>	<b>22.70</b>	<b>69.95</b>	<b>48.83</b>	<b>50.95</b>	<b>44.14</b>




d) Përmirësimi në përqindje i treguesve sipas paisjeve Janar-Shtator, 2016-2019

Emri i paisjeve	Përmirësimi i SAIDI 2016-2019	Përmirësimi i SAIFI 2016-2019
Linjë	58%	43%
Nënstacion	-9%	18%
Transformator	48%	18%
Çela/10/20/35	49%	44%
Të ndryshme	-203%	-194%
<b>HV</b>	<b>31%</b>	<b>21%</b>
Fidera	37%	24%
Çela Kabine	46%	43%
<b>MV</b>	<b>38%</b>	<b>28%</b>
<b>Total OSHEE</b>	<b>37%</b>	<b>27%</b>


e) Analiza e treguesve të performancës së rrjetit TM sipas zonave urbane, rurale dhe rurale e thellë për periudhën Janar –Shtator 2019.

Rrjeti 6-10-20 kV viti 2019


	Total	Urban	Rural	Rural i thelle
<b>Janar 2019</b>	2.3	1.13	3.39	5
<b>Shkurt 2019</b>	3.04	1.05	4.71	8.02
<b>Mars 2019</b>	1.74	0.69	2.72	4.12
<b>Prill 2019</b>	1.74	0.83	2.67	3.63
<b>Maj 2019</b>	1.71	0.87	2.57	3.51
<b>Qershor 2019</b>	2.47	1.24	2.62	3.99
<b>Korrik 2019</b>	2.09	0.86	3.32	4.7
<b>Gusht 2019</b>	1.38	0.55	2.18	3.28
<b>Shtator 2019</b>	1.97	0.73	3.1	4.9



	<b>Total SAIDI</b>	<b>Urban SAIDI</b>	<b>Rural SAIDI</b>	<b>Rural I thelle SAIDI</b>
Janar 2019	4.04	1.33	6.51	10.44
Shkurt 2019	7.39	1.9	11.94	21.26
Mars 2019	3.19	0.95	5.62	7.61
Prill 2019	3.59	1.58	5.34	8.45
Maj 2019	3.27	1.4	5.18	7.25
Qershor 2019	4.14	1.89	4.23	7.24
Korrik 2019	3.53	0.99	6.01	9.08
Gusht 2019	2.5	0.75	4	9
Shtator 2019	3.8	1	6.5	10.5



**Performanca e rrjetit TM sipas zonave urbane/rural/rural i thelle per periudhen Janar-Shtator 2019**



Në rrjetin që shtrihet në zonat rurale dhe rurale të thella treguesit vazhdojnë të jenë në vlera mjaft të larta 4 deri 7 herë më të larta se ato në zonat urbane, kjo për shkak të amortizimit dhe ndikimit të kushteve atmosferike në linjat ajrore, veshtirësitë në lokalizimin dhe gjetjen e difekteve etj.

Në muajin Shtator kur koha ka qenë e keqe me erë të fortë për disa ditë të muajit e ka bërë më të thellë diferencën e performancës së rrjetit në zonat rurale dhe rurale të thella.

Për shkak të ndërprerjeve në rrjetin TM në periudhën Janar-Shtator 2019 nga 17 abonentë të prekur në total,

- 7 abonentë janë prekur në zonat urbane që përbëjnë 22% të abonentëve total të OSHEE
- 26 abonentë në zonat rurale që përbëjnë 45% të abonentëve total të OSHEE
- 39 abonentë janë prekur në zonat rurale të thella që përbëjnë 33 % të abonentëve total të OSHEE

Sikurse duket edhe grafikisht në zonat rurale të thella dhe ato rurale vazhdon amortizimi i rrjetit por moti i keq ka ndikuar dhe provokuar stakime edhe në rrjetin TM 6-10kV të zonave urbane. Peshën specifike më të madhe në performancë e përbëjnë difektet në zonat rurale të thella që së bashku me ato në zonat rurale shkojnë në 78%.

○ **Rrjeti 6-10-20 kV për periudhën Janar –Shtator 2019:**

Kategori	Saidi	Saifi
Janar-Shtator TM - 20kV	6.98	5.96
Janar-Shtator TM 6-10kV	45.76	22.24
<b>Total TM Janar - Shattor</b>	<b>34.08</b>	<b>17.65</b>

Performanca e rrjetit Janar-Shtator 2019 (6-10-20kV)



Pesha specifike që zenë ndërprerjet për shkak të difekteve në rrjetin 6-10kV dhe 20kV:


EMËRTIMI	Pesha specifike SAIFI	Pesha specifike SAIDI
Tensioni Mesëm 20kV OSHEE Janar-Shtator	6%	11%
Tensioni Mesëm Fider 6-10kV OSHEE Janar -Shtator	94%	89%



SAIDI Pesha specifike qe zene rrjeti TM sipas niveleve te tensionit



SAIFI Pesha specifike qe zene rrjeti TM sipas niveleve te tensionit




■ Total 20kV ■ Total 6-10


